



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 45

Prishtinë, më 28.06.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, C- 203

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Njomza Emini, Vjosa Osmani, Luljeta Gutaj-Veselaj, Bislim Zogaj, Arben Gashi, Donika Kadaj- Bujupi, Slobodan Petroviç dhe Kujtim Paqaku.

Munguan: Xhavit Haliti (në udhëtim zyrtar), Valdete Bajrami dhe Time Kadrijaj.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi, znj. Njomza Emini, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 23.5.2016;**
- 3. Raportimi i z. Hajredin Kuçi, ministër i Drejtësisë;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-087 për kundërvajtje, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, hapi mbledhjen dhe njoftoi se në emër të Komisionit i është bërë ftesa ministrit të Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi. Ai ka konfirmuar ardhjen dhe stafin, me kohë, ka shpërndarë materialin dhe ka bërë përgatitjet për mbledhje, pastaj ministri ka kërkuar mirëkuptim për ta ndryshuar datën e raportimit, sepse kishte një udhëtim zyrtar në Shqipëri. Pasi e kemi edhe një projektligj për shqyrtim, mendova ta mbajmë mbledhjen dhe së bashku ta vendosim datën se kur do ta ftojme ministrin, që të raportojë para Komisionit.

Vjosa Osmani, tha se deri më tani, ky Komision nuk ka pasur probleme me ministrat, sepse i janë përgjigjur çdoherë ftesës së Komisionit pozitivisht, mirëpo për shkak të rrethanave politike, për një kohë të gjatë është ulur tempu i punës dhe plani i punës ka mbetur mbrapa. Ne duhet të rrisim tempin e punës, dhe në të njëjtën kohë, duhet të ketë më shumë raportime të ministrave, sepse fusha e integritit evropian, siç shihet edhe në Raportin e Progresit, përfshin pothuajse fushëveprimin e çdo ministrie. Ftesa t'i bëhet ministrit menjëherë për të hënë ose të mërkurën, pasi të martën është ditë pushimi.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se anëtarët u pajtuan që t'i bëhet ftesa ministrit për javën ardhshme, që të raportojë para Komisionit.

Rendi i ditës u miratua me ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.5.2016

Kryetarja e Komisionit i pyeti anëtarët se a kanë vërejtje në procesverbal.

Vjosa Osmani, nuk kishte vërejtje në procesverbal, por kishte vërejtje në transkriptin e dt.3.6.2016, sepse tha se janë bërë disa lëshime dhe kërkoi nga stafi, që kur ta marrin nga njësia që i harton transkriptet, para se të miratohet nga anëtarët, t'i kontrollojë edhe një herë, sepse në disa fjalë mungon nga një shkronjë dhe pastaj po iu ndërrohet kuptimi.

Procesverbali i dt.23.5.2016, u miratua.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-087 për kundërvajtje, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja, lidhur me këtë projektligj, paraqiti opinionin ligjor.

Projektligji nr. 05/L-087 për kundërvajtje, me amendamentet e Komisionit Funkcional, janë shqyrtuar dhe pasi është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj, nuk cenon parimet e legjislacionit të BE-së dhe mund të rekomandohet për procedurë të rregullt në Kuvend.

Në vazhdim, hapi diskutimin dhe pastaj e hodhi në votim projektligjin, me amendamentet e Komisionit Funkcional .

Donika Kadaj- Bujupi, tha se do të abstenoj, sepse e kam marrë materialin me vonesë dhe si anëtare e re e Komisionit, është hera e parë që marrë pjesë në takim, andaj kërkoi nga administrata, që për mbledhjet e ardhshme, të koordinohemi më mirë dhe ta marr materialin me kohë.

Pasi nuk kishte diskutues të paraqitur, kryetarja, pas votimit, konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 05/L-087 për kundërvajtje, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, dhe si i tillë, mund të procedohet për miratim në Kuvend.

4. Të ndryshme

Kryetarja, lidhur me këtë pikë, hapi diskutim.

Vjosa Osmani, tha se në agjendë të Komisionit, para dy javësh, e kemi pasur raportimin e Komisionit Shtetëror për Demarkacionin, sepse çështja e demarkacionit tashmë konsiderohet kusht për liberalizimin e vizave dhe të gjitha ato kritere që deri më tani janë plotësuar dhe ato që nuk janë plotësuar, gjithmonë bien në fushëveprimin e këtij Komisioni.

Herën e kaluar nuk u realizua takimi, për shkak të incidentit që e pati Murat Meha, por mua m'u krijua përshtypja që u harrua ajo çështje dhe nuk po e ftojme fare. Nuk e di pse është tejkaluar ajo çështje, a është ftuar përsëri nga Komisioni, sepse nuk do të thotë që nëse ka qenë ai incidenti, nuk do të thotë që mos të ftohet fare.

Ka pasur dakordim unanim që të ftohet Komisioni Shtetëror për Demarkacionin dhe të diskutojmë për çështjen e demarkacionit, sepse kurdo që vjen marrëveshja në Kuvend, ne si deputetë nuk kemi informata të bollshme për të marrë një vendim përfundimtar për votën tonë.

U patëm dakorduar në mbledhjen e kaluar, që përveç Komisionit shtetëror, të ftohet edhe pala tjetër, që nënkupton se duhet të ftohen edhe ekspertë të kësaj fushe dhe ata profesorë që kanë qenë shumë aktivë në këtë fushë, pjesëtarë të shoqërisë civile, deputetë tjerë të Kuvendit, të cilët kanë të drejta të plota, të vijnë, të flasim, por jo të votojmë, sepse ne në atë takim nuk kemi për të vendosur asgjë, sepse është vetëm çështje diskutimi dhe ballafaqim i argumenteve.

Bislim Zogaj, tha se në herën e kaluar kërkuam që të vijnë të dy palët, ndërsa nëse nuk arrijnë të vijnë të dy palët dhe të ballafaqohemi në Komision për të na sqaruar, vota ime do të jetë abstenim, sepse ende nuk jam i vendosur a do të votoj për apo kundër.

Donika Kadaj- Bujupi, theksoi se vitin e kaluar, para nënshkrimit të marrëveshjes së 25 gushtit, të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë nxjerrë bashkë një rezolutë, e cila në pikën kryesore të saj ka paraparë që para nënshkrimit të marrëveshjes, materialet përkatëse që kanë të bëjnë me demarkacionin, të sillen në Kuvend, rrjedhimisht përmes komisioneve dhe në seancë plenare, të diskutohen dhe të shqyrtohen paraprakisht, para nënshkrimit të marrëveshjes, se cilat janë shqetësimet dhe vetëm pas miratimit nga ana e Kuvendit, të procedohet me nënshkrim.

Përgjegjës kryesor konsideroj se është Hashim Thaçi, i cili ka nënshkruar marrëveshjen në kundërshtim me rezolutën, dhe në kohën kur Kuvendi ishte në pushim, ta rikthejë në Kuvend, pa e zhvlerësuar një marrëveshje të tillë, është e papranueshme.

Në vazhdim, tha se fillimisht, si Kuvend, të kërkojmë që kjo marrëveshje të zhvlerësohet dhe mos të vijë si e tillë në Kuvend dhe pastaj të fillojmë prej fillimit, ashtu siç është paraparë me rezolutën e votuar nga deputetët e pozitës dhe opozitës, në vitin e kaluar.

Prandaj, ta kemi një dakordim që ta kthejmë në pikën zero, në kuptimin e zhvlerësimit si Kuvend, pastaj mund të fillojë argumentimi, debati dhe pastaj t'i nxjerrim argumentet për dhe kundër.

Ne e dimë që, dy herë, kemi pasur përvoja të këqija, ku deputetët kanë menduar ndryshe, kanë votuar ndryshe dhe janë detyruar në momentin e fundit të ndërrojnë qëndrimin e tyre.

Kësaj here, bëhet fjalë për një çështje e cila nëse humbet sot, atëherë do të ketë pasoja për gjenerata dhe nuk mund ta rikthejmë dhe ta rishqyrtojmë.

Luljeta Gutaj- Veselaj, tha se është bërë kohë e gjatë që ne si deputetë diskutojmë për këtë marrëveshje, qoftë në sallat e Kuvendit, qoftë në takime të ndryshme, por asnjëherë nuk na është dhënë hapësirë, që të diskutojmë dhe të debatojmë. Kjo është gjëja më e keqe që mund t'i ndodhë një Kuvendi.

Kam veç një pyetje për kolegët e opozitës, pse pengohet kryetari i Komisionit për demarkacionin, që të vijë për të raportuar dhe për t'u ballafaquar me argumente?

Personalisht, kam shumë dilema dhe nuk e di a t'iu besoj qytetarëve me argumente, a t'iu besoj Komisionit, pse pengohet debati në Kuvend?

E përkrah idenë që prapë të ftohet Komisioni për raportim, por kërkoj nga kolegët e opozitës që mos ta pengojnë, sepse në qoftë se pengohet, atëherë ka një fakt që po dëshirojnë diçka të parandalojnë ose të ndalojnë.

Vjosa Osmani, lidhur me diskutimin e deputetes Donika, tha se plotësisht e kuptoj qëndrimin tuaj për zhvlerësimin e marrëveshjes. Ai është qëndrimi i juaj politik, mirëpo proceduralisht nuk e lejon as Rregullorja e Kuvendit dhe as ndonjë dokument tjetër, që ajo marrëveshje të vijë e të diskutohet.

Ata nuk mund ta sjellin marrëveshjen, por vjen Komisioni me disa raporte që i ka shkruar.

Marrëveshjen mund ta sjellë vetëm Qeveria, që e ka negociuar dhe e ka nënshkruar. Pra, pasi të kalojë ai dokument në Qeveri, mund të vijë dhe të kalojë në komisione tjera, që merren me çështje të marrëveshjeve ndërkombëtare, siç janë Komisioni për Legjislacion dhe ai për Punë të Jashtme, kurse ne nuk mund ta kalojmë, sepse është kundër kushtetuese dhe kundër rregullores, përveç MSA-së që është marrëveshje ndërkombëtare dhe ka rënë në fushëveprimin e Komisionit tonë.

Ne nuk po e ftojmë Komisionin të shikojmë dokumentin e marrëveshjes dhe për t'i dhënë dritën e gjelbër. Në këtë Komision, nuk do të ketë vendim dhe nuk ka asnjë mënyrë që ai vendim pastaj ta kontrabandojë marrëveshjen në Kuvend, sepse edhe ashtu nuk do të lejohet, pa pasur një rekomandim nga Komisioni për Legjislacion dhe ai për Punë të Jashtme.

Propozoj që të ndërrohet formati dhe ta mbajmë në formë tryeze në Kuvend ose jashtë Kuvendit dhe të ftohen të dyja palët, si dhe të ballafaqohen argumentet.

Luljeta Gutaj- Veselaj, pajtohet me idenë që të mbahet në formë tryeze dhe kolegët deputetë të vijnë, sepse janë njoftimet e hapura për mbledhje të komisioneve dhe kush është i interesuar mund të marrë pjesë, por jo jashtë Kuvendit, sepse përderisa pengohet Komisioni të vijë në Kuvend, si institucioni më i lartë shtetëror, atëherë si do të lejojnë të vijnë në një lokal.

Arben Gashi, tha se sa kam kuptuar nga prononcimet e kryeministrit, se Komisioni nuk ekziston më dhe ne nuk mund të ftojmë diçka që nuk e ekziston më.

Frika se në Komisionin për Integritet Evropian mund të kontrabandohet marrëveshja për demarkacionin, nuk ka shans as teorike dhe as praktike që të kontrabandohet, sepse e dimë mirë që një marrëveshje ndërkombëtare ratifikohet me listë të veçantë, e cila duhet t'i dorëzohet Kuvendit nga Qeveria, pastaj ligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare do të shkojë në Kryesi dhe pastaj Kryesia e cakton Komisionin Funkcional, i cili pastaj e bën raportin që ua dorëzon komisioneve të përhershme, pastaj dorëzohet për seancë. Pra, seanca është ajo që vendos pastaj.

Murat Meha, si ekspert, vjen në Komision si çdo qytetar tjetër. Nëse Komisioni vendos ta ftojë për shkak të njohurive që ka, e jo si kryetar i Komisionit, sepse Komisioni e ka kryer punën dhe ia ka dorëzuar materialin Qeverisë.

Pra, t'i qartësojmë gjërat. E para, nuk ka shans të kalojë në Komisionin tonë ai projektligji, sepse nuk ekziston dhe nuk ka hyrë në procedura kuvendare. E dyta, personi që vjen nuk vjen në cilësinë e kryetarit të Komisionit, por në cilësinë e personit që ka qenë direkt i involvuar në këto çështje dhe duam të kemi informacion shtesë.

Nuk është me rëndësi se a mbahet në Kuvend apo jashtë, me rëndësi është të dimë se kë po e thërrasim, pse po e thërrasim dhe çka mund të bëjë ai në Komision.

Donika Kadaj- Bujupi, lidhur me tryezën tha se të gjithë kemi përvojë të mjaftueshme me procedurat e Kuvendit dhe shkeljen e tyre. Po e shoh që prapë po evitohet fakti që para nënshkrimit të marrëveshjes ka ekzistuar një rezolutë e cila është shkelur dhe nuk është hera e parë që nuk merren parasysh vendimet e deputetëve. Rezolutat e ligjet shkelen dhe merren vendimet, që në forma të ndryshme, përkundër procedurave, legjitimohen. Edhe në këtë rast, vazhdon të ekzistojë një përpjekje që të legjitimohet humbja e mbi 8 mijë hektarëve tokë, përderisa ekziston një përpjekje që ata të cilët janë të gatshëm t'i thonë, jo humbjes së territoreve, të abstenojnë, në njëfarë forme në mungesë informacionit, por nuk besoj që në këta 8 muajt e fundit, dikush ka pasur mangësi të informacionit, sepse janë bërë studime të vazhdueshme, publikime për çështjen në fjalë dhe janë organizuar shumë tryeza.

A vendosni të organizoni tryezë jashtë Kuvendit, ajo është çështje që iu mbetet individëve të caktuar, të cilët pavarësisht qëndrimit tonë, mund të organizojnë tryeza, mirëpo të pretendohet që do ta gjejnë zgjidhjen përmes personit, i cili është shkaktar ose zbatues, sepse konsideroj se vendimin e ka marrë tjetërkush dhe Murat Meha e ka zbatuar një demarkacion të tillë, ku Kosova humb 8 mijë hektarë tokë. Pra, të pretendojnë deputetët që prej tij marrin përgjigje të sakta për demarkacionin, nuk qëndron.

Mund të bëhet ndonjë përpjekje për ta kthyer në normalizim, mirëpo ajo që dua të rikonfirmoj, është se ajo marrëveshje nuk duhet të silllet në Kuvend, dhe nëse Qeveria vendos që ta sjellë, atëherë do të jetë përgjegjëse për të gjitha veprimet që do të ndodhin brenda dhe jashtë Kuvendit, në kundërshtim të kësaj marrëveshjeje.

Bislim Zogaj, konsideron se u stërzgjat kjo temë. Pra, kemi nevojë për sqarim, ndërsa a ka ditur apo nuk ka ditur Murat Meha, është krejt temë tjetër. Dhe përderisa ai është ekspert i asaj fushe, sepse ne nuk jemi ekspertë të asaj fushe, deri më tani nuk e kam parë asnjë debat televiziv apo në ndonjë komision, që janë ballafaquar ata që janë për dhe ata që janë kundër. Pra, përderisa nuk ballafaqohen ekspertët e të dyja palëve, për mua është e pamundur të vlerësohet se cili ka të drejtë. Problemi nuk është te sqarimi as për opinion, as për askënd, por për mua, sepse dua ta di si të votoj, sepse nuk mund të them se do të votoj, para se të dy palët të ballafaqohen mes veti.

Vjosa Osmani, vlerësoi se këtu është krijuar një keqkuptim, sepse askush nuk po kërkon të marrë përgjigje të sakta prej Murat Mehës apo dikujt tjetër, por pretendimi ynë është që të ketë ballafaqim argumentesh, sepse këtu, përveç Murat Mehës me ekipin e tij, do të jenë edhe ekipi tjetër, që deri më sot ka pasur qëndrime të kundërta. Ndoshta, janë organizuar qindra tryeza, por unë nuk kam qenë e ftuar në asnjë tryezë, deri më sot. Është me rëndësi që këto diskutime të bëhen edhe para deputetëve, sepse askush tjetër, përveç neve deputetëve, nuk ka për të votuar. Domosdoshmërisht, kjo çështje do të vijë në Kuvend. Nuk e di kur do të vijë, sepse nuk do të na pyesin neve si Komision, pavarësisht se a është tani kryetar i Komisionit apo ish- kryetar, tani nuk ka rëndësi.

Donika Kadaj- Bujupi, theksoi edhe një herë dua të konfirmoj se sot e asnjëherë, nuk do të pajtohemi që Qeveria t'i informojë deputetët, pasi ta vënë nënshkrimin në një dokument, cilido qoftë ai, e sidomos në një dokument të cilit i ka paraprirë një rezolutë, e cila ka kërkuar që Kuvendi të njoftohet, paraprakisht, do të thotë para nënshkrimit.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

Vendim

Të organizohet një tryezë, në të cilën do të ftohet kryetari i Komisionit Shtetëror për Demarkacion, ekspertë të kësaj fushe, deputetë të interesuar dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Njomza Emini